

L I G J

Nr.8523, date 9.9.1999

PER ADERIMIN E REPUBLIKES SE SHQIPERISE NE KONVENTEN PER MJETET E NDALIMIT DHE TE PARANDALIMIT TE IMPORTIT, EKSPORTIT DHE TRANSFERIMIT TE PALIGJSHEM TE PRONESISE SE PASURISE KULTURORE

Ne mbeshtetje te neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 te Kushtetutes, si dhe te ligjit nr.8371, date 9.7.1998 "Per lidhjen e traktateve dhe marreveshjeve nderkombetare", me propozimin e Keshillit te Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqiperise aderon ne Konventen per mjetet e ndalimit dhe te parandalimit te importit, eksportit dhe transferimit te paligjshem te pronesise se pasurise kulturore.

Neni 2

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare

Shpallur me dekretin nr.2445, date 9.9.1999 te Presidentit te Republikes se Shqiperise, Rexhep Meidani

KONVENTA MBI MJETET E NDALIMIT DHE TE PARANDALIMIT TE IMPORTIT DHE EKSPORTIT DHE TRANSFERIMIT TE PALIGJSHEM TE PRONESISE SE PASURISE KULTURORE

Miratuar nga Konferenca e Pergjithshme mbajtur ne sesionin e 16-te Paris, 14 nentor 1970

UNESCO

Konferenca e Pergjithshme e Organizates Kulturore, Arsimore Shkencore e Kombeve te Bashkuara qe u mbledh ne Paris nga 12 tetor deri 14 nentor 1970 ne sesionin e saj te 16-te.

Duke kujtuar rendesine e klauzolave te perfshira ne Deklaraten e Parimeve per Bashkepunimin Kulturor Nderkombetar, te miratuar nga Konferenca e Pergjithshme ne sesionin e saj te 14-te,

Duke konsideruar qe shkembimi i pasurive kulturore ndermjet kombeve per qellime shkencore, kulturore e arsimore zgjeron njohurite e qyteterimit te Njeriut, pasuron jeten kulturore te te gjithë popujve dhe frymazon respektin reciprok dhe vleresimin ndermjet kombeve,

Duke pasur parasysh qe kjo pasuri kulturore perben nje nga komponentet themelore te qyteterimit dhe kultures kombetare dhe se vlera e saj e vertete mund te vleresohet vetem ne raport me informacionin e dhene sa me i plote qe te jete i mundur ne lidhje me origjinen, historine e traditat,

Duke konsideruar qe eshte detyre e çdo shteti te mbroje pasurite kulturore ekzistuese brenda territorit te tij kunder rreziqeve te vjedhjes germimeve klandestine dhe eksportit te

paligjshem,

Duke pasur parasysh qe, per te menjanuar keto rreziqe, eshte e rendesishme per cdo shtet te behet mjaft i vetedijshem per te respektuar detyrimet morale ndaj trashegimise se vet kulturore dhe ate te gjithë kombeve,

Duke marre parasysh institucionet kulturore, muzeumet, bibliotekat dhe arkivat duhet te garantoje qe koleksionet e tyre te ngrihen ne perputhje me parimet morale te njohura boterisht,

Duke konsideruar qe importi, eksporti dhe transferimi i paligjshem i pronesise te pasurise kulturore eshte nje pengese per ate mirekuptim, qe duhet te arrihet midis kombeve, e cila eshte pjese e Misionit te Unescos per ta nxitur duke u rekomanduar Shteteve te interesuar, konventa nderkombetare me kete qellim,

Duke e konsideruar qe mbrojtja e trashegimise kulturore mund te jete e efektshme vetem nese eshte e organizuar si ne nivel kombetar edhe ne ate nderkombetar ndermjet shteteve qe punojne ne kooperim te ngushte,

Duke pasur parasysh qe Konferenca e Pergjithshme e Unescos miratoi nje Rekomandim per kete qellim ne 1964,

Duke pasur edhe me perpara propozime plotesuese mbi mjetet e ndalimit dhe parandalimit te importit, eksportit dhe kalimit te paligjshem te pronesise se pasurive kulturore, çeshtje e cila eshte ne axhenten e ketij sesioni si pika 19.

Pasi ka vendosur ne sesionin e tij te pesembedhjete, qe kjo ceshtje duhet te behet tema e nje konvente nderkombetare,

Miraton kete Konvente me katermbedhjete nentor 1970.

Neni 1

Per qellimet e kesaj Konvente, termi "pronesi kulturore" do te thote pronesi e cila, ne qarqet fetare apo civile, specifikohet nga cdo shtet si dicka me rendesi per arkeologjine, prehistorine, historine, letersine, artin apo shkencen dhe e cila i perket kategorive te meposhtme:

- (a) Koleksionet e rralla dhe monstat e faunes, flores, mineraleve dhe anatomist, si dhe objektet me interes palaeontologjik;
- (b) pronesia e lidhur me historine, duke perfshire historine e shkences e teknologjise, si dhe historine ushtarake dhe shoqerore, me jeten e udheheqesve kombetare, dijetareve, shkencetareve dhe artisteve dhe me ngjarjet e nje rendesie kombetare;
- (c) objektet e germimeve arkeologjike (duke perfshire te rregulltat dhe klandestinet)

ose te zbulimeve arkeologjike;

(d) elemente te monumenteve artistike apo historike ose te qendrave arkeologjike te cilat jane copezuar;

(e) antikitetet me te vjetra se njeqind vjet, sic jane mbishkrimet, monedhat dhe vulat e skalitura; .

(f) objekte me interes etnologjik;

(g) pasuri me interes artistik, sic jane:

(i) pikurat, vizatimet portrete te prodhuara teresisht me dore mbi cdo lloj materiali dhe mbeshetjeje (duke perjashtuar projektet industriale dhe artikujt e prodhuar me makine, por te

zbukuruar me dore);

(ii) vepra origjinale te artit te statujave dhe skulpturave ne cdo material;

(iii) gdhendje origjinale, gravura dhe litografi;

(iv) koleksion artistik origjinal dhe montazhe prej cdo materiali;

(h) doreshkrime te rralla dhe ,, libra te vjeter, dokumente dhe botime me interes te vecante (historik, artistik, shkencor, letrar etj.) te vetme ose ne koleksion;

(i) tarifa postare, te ardhura dhe pullat e ngjashme, unike ose ne koleksion;

(j) arkivat, duke perfshire arkivat zanore, fotografike dhe kinematografike;

(k) objekte mobiljesh me te vjetra se njeqind vjet dhe intrumente te vjeter muzikor.

Neni 2

1. Shtetet pale ne kete Konvente e kuptojne se importi, eksporti dhe kalimi i paligjshem i pronesise se pasurise kulturore eshte nje nga shkaqet kryesore te varferimit te trashegimise kulturore te vendeve te origjines se ketyre pasurive dhe bashkepunimi nderkombetar perben nje nga mjetet me efikase per mbrojtjen e pasurise kulturore te secilit vend kunder te gjitha rreziqeve te rezultuara deri me sot.

2. Per kete qellim shtetet pale zotohen te kundershtojne praktika te tilla me mjetet qe kane ne dispozicion dhe vecanerisht duke eliminuar shkaqet, duke ndaluar praktikat e tanishme dhe duke ndihmuar per te bere reparacionet e nevojshme.

Neni 3

Importi, eksporti ose kalimi i pronesise te pasurive kulturore te kryera ne kundershtrim me klauzolat e miratuara ne kete Konvente nga shtetet pale do te quhet e paligjshme.

Neni 4

Shtetet pale te kesaj Konvente e kuptojne se per shkak te Konventes pasuria e cila i perket kategorive te meposhtme perben pjesen e trashegimise kulturore te secilit shtet:

a. Pasuria kulturore e krijuar nga gjeniu individ ose kolektiv i kombesave te shtetit te interesuar dhe pasuria kulturore qe paraqet rendesi per shtetin perkates i krijuar brenda territorit te atij shteti nga kombes te huaj ose persona pa shtetesi rezident ne kete territor;

b. pasuria kulturore e gjetur ne territorin nacional;

c. pasuria kulturore e perfituar nga misionet arkeologjike, etnologjike ose shkencave

- natyrore, me pelqimin e autoriteteve kompetente te vendit te origjines se kesaj pasurie;
- d. pasuri kulturore qe ka qene subjekt i nje shkembimi te rene dakord me vullnet te lire;
 - e. pasuria kulturore e perftuar si nje dhurate apo blerje e ligjshme me pelqimin e autoriteteve kompetente te vendit te origjines se kesaj pasurie.

Neni 5

Per te siguruar mbrojtjen e pasurise se tyre kulturore kunder importit, eksportit dhe kalimit te paligjshem te pronesise, Shtetet Pale te kesaj Konvente zotohen te ngrene brenda teritoreve te tyre nje a me shume sherbime kombetare, te pershtatshme per secilin vend, aty ku keto sherbime nuk ekzistojne, per mbrojtjen e trashegimise kulturore, me nje staf te kualifikuar e te mjaftueshem ne personel per zbatimin efektiv te funksioneve te meposhtme:

- (a) te kontribuojne ne hartimin e projektligjeve dhe rregulloreve qe kane qellim te sigurojne mbrojtjen e trashegimise kulturore dhe vecanerisht parandalimin e importit, eksportit dhe kalimit te paligjshem te pronesise;
- (b) vendosjen dhe mbajtjen ne korrent mbi bazen e nje inventari kombetar te pasurise se mbrojtur, nje liste te pasurise me te rendesishme kulturore private dhe publike, eksportimi i se ciles do te shkaktonte nje varferim te konsiderueshem te trashegimise kulturore kombetare;
- (c) promovimi i zhvillimit ose i ngritjes se institucioneve teknike dhe shkencore (muzeumet, bibliotekat, arkivat, labororet, punishtet...) kerkojne te sigurohet ruajtja dhe prezantimi i pasurise kulturore.
- (d) organizimi i mbikeqyrjes se germimeve arkeologjike, duke siguruar ruajtjen "in situ" te pasurise se percaktuar kulturore dhe mbrojtja e zonave te caktuara, te rezervuara per kerkime arkeologjike ne te ardhmen;
- (e) vendosja, per te miren e te interesuarve (pergjegjesit e muzeve, koleksionistet, tregtaret antikuare etj.) e rregullave ne perputhje me parimet etike te parashtruara ne kete konvente; dhe marrja e masave per te siguruar mbikeqyrjen e ketyre rregullave;
- (f) marrja e masave arsimore per te stimuluar dhe zhvilluar respektin per trashegimine kulturore te te gjitha shteteve dhe perhapja e njohurive te klauzolave te kesaj Konvente;
- (g) te shikoje qe te behet publiciteti i duhur ne rast zhdukjeje te ndonje objekti te pasurise kulturore.

Neni 6

Shtetet Pale te kesaj Konvente ndermarrin:

- (a) Te prezantojne nje certifikate te pershtatshme ne te cilen shteti eksportues do te specifikojte qe eksporti i pasurise kulturore ne fjale eshte i autorizuar. Certifikata duhet te shoqeroje te gjitha artikujt e pasurise kulturore te eksportuar ne perputhje me rregulloret;
- (b) te ndaloje eksportimin e pasurise kulturore nga territori i tyre nese nuk eshte i shoqeruar nga certifikata e mesiperme e eksportit;
- (c) te beje publike kete ndalim me ane te mjeteve te duhura, vecanerisht ndermjet personave qe merren me eksportimin apo importimin e pasurise kulturore

Neni 7

Shtetet pale te kesaj Konvente ndermarrin:

a. Te marrin masat e nevojshme, ne perputhje me legjislacionin kombetar, per te parandaluar qe muzeumet dhe institucionet e ngjashme brenda territorit te tyre te perftojne pasuri kulturore me origjine nga nje shtet pale, e cila eshte eksportuar ilegalisht pas hyrjes ne fuqi te kesaj Konvente ne shtetet perkatese. Kurdo qe te jete e mundur, te informohet shteti i pales origjine e kesaj Konvente te nje oferte te nje pasurie kulturore te tille te larguar ilegalisht nga shteti pas hyrjes ne fuqi te kesaj Konvente ne te dyja shtetet;

b.(i) te ndaloje importimin e pasurise kulturore te vjedhur nga nje muzeum ose monument fetar ose publik civil apo nga nje institucion i ngjashem apo nje shtet tjetër pale ne kete Konvente pas hyrjes ne fuqi te kesaj Konvente per shtetet e interesuara me kusht qe kjo pasuri te jete e dokumentuar ku tregohet qe i perket inventarit te atij institucioni;

(ii) me kerkesen e shtetit pale te origjines, te ndermerren masat e duhura per te zbuluar dhe kthyer keto lloj pasurish kulturore te importuara pas hyrjes ne fuqi te kesaj Konvente ne te dy shtetet perkatese, me kusht qe, sidoqofte shteti kerkues do te paguaje vetem kompensimin per nje bleres te pafajshem ose tek nje person qe gezon te drejta te vlefshme ndaj kesaj pasurie. Kerkesat per zbulimin dhe kthimin do te behen nepermjet rrugeve diplomatike. Pala kerkuese do te siguroje me shpenzimet e veta dokumentacionin dhe deshmite e tjera te nevojshme per te mbeshtetur ankesen e vet per gjetjen dhe kthimin. Palet nuk do te imponojne asnje dogane ose tatime te tjera mbi pasurite kulturore te kthyer ne zbatim te ketij neni. Te gjitha shpenzimet te lidhura me kthimin dhe shperndarjen e pasurise kulturore do te perballohen nga palet kontraktuese.

Neni 8

Shtetet pale te kesaj Konvente zotohen te vendosin gjoba ose sanksione administrative mbi cdo person pergjegjes per shkelje te ndalimeve sic jane referuar ne nenet e mesiperme 6(b) dhe 7 (b).

Neni 9

Cdo shtet pale, ne kete Konvente, trashegimia kulturore e te cilit eshte ne rrezik nga plackitjet e materialeve arkeologjike ose etnologjike, mund t'u beje thirrje shteteve te tjera pale qe jane prekur. Shtetet anetare te kesaj Konvente angazhohen, ne keto kushte, te marrin pjese ne nje perpjekje nderkombetare te bashkerenduar per te vendosur dhe per te zbatuar masat konkrete te nevojshme, duke perfshire kontrollin e eksporteve dhe importeve dhe tregtine nderkombetare per materialet specifike perkatese. Per marreveshjet e pazgjidhura cdo shtet i interesuar do te vere masa kushtezuese deri ne ate mase te mundur me qellim te parandaloje demtimet e pandreqshme ndaj trashegimise kulturore te shteteve te interesuara.

Neni 10

Shtetet pale ne kete Konvente ndermarrin:

(a) Te kufizojne nepermjet edukimit, informacionit dhe vigjilencees, levizjet e pasurise kulturore te larguara ilegalisht nga ndonje Shtet anetar te kesaj Konvente dhe si te jete me e pershtatshme per seeilin vend, te detyroje tregtaret antikuare, t'i nenshtrohen sanksioneve penale ape administrative, te mirembajne regjistrin ku te shenojne origjinen e seeilit artikull te pasurise kulturore, emrat dhe adresat e firmes furnizuese, pershkrimin dhe cmimin e seeilit artikull te shitur dhe te informoje bleresin e pasurise kulturore se ndalohet eksportimi i kesaj lloj pasurie me ligj.

(b) Te perpiqet me mjetet edukuese te krijojte dhe te zhvilloje ne opinionin publik nje kuptim te vlerave te pasurise kulturore dhe te kercenimit te pasurise kulturore te krijuara nga vjedhja, germimet klandestine dhe eksporti i paligjshem.

Neni 11

Eksporti dhe transferimi i pronesise se pasurise kulturore me detyrim, qe rrjedh direkt ose indirekt nga pushtimi i nje vendi nga nje fuqi e huaj, do te konsiderohet si i paligjshem.

Neni 12

Shtetet anetare te kesaj Konvente do te respektojne trashegimine kulturore brenda territorit per marredheniet nderkombetare te cilave ata jane pergjegjes, dhe do te marrin masat e pershtatshme per te ndaluar dhe parandaluar importin, eksportin dhe kalimin e paligjshem te pasurise kulturore ne keto terriore.

Neni 13

Shtetet pale te kesaj konvente gjithshu ndermarrin, ne perputhje me ligjet e secilit shtet:

(a) Te parandalojne me te gjitha mjetet e duhura kalimet e pronesise te pasurise kulturore qe nxisin importin dhe eksportin e paligjshem te kesaj lloj pasurie:

(b) per te siguruar qe sherbimet e tyre kompetente bashkepunojne ne lehtesimin a rikthimin sa me shpejte jete e mundur te pasurive kulturore te eksportuara ilegalisht tek pronari i duhur;

(c) te pranojne veprimet per gjetjen e artikujve te humbur ose te vjedhur te pasurise kulturore qe behen nga/ose ne emer te pronareve te ligjshem;

(d) te dalloje te drejten e pamohueshme te cdo Shteti anetar ne kete konvente per te klasifikuar dhe deklaruar pasurite te caktuara kulturore si te patjetersueshme te cilat atehere nuk duhet ipso facto te eksportohen dhe te lehtesoje gjetjen e kesaj lloj pasurie nga Shteti i interesuar ne rastet ku ai eshte eksportuar.

Neni 14

Me qellim qe te parandalojne eksportin e paligjshem dhe per te plotesuar detyrimet qe rrjedhin nga zbatimi i kesaj Konvente, cdo Shtet Anetar ne kete Konvente duhet, aq sa te jete e mundur, te siguroje sherbimet kombetare pergjegjes per mbrojtjen e trashegimise se tij kulturore me nje buxhet te mjaftueshem dhe, ne se eshte e nevojshme, duhet te ngreje nje fond per kete qellim.

Neni 15

Asgje ne kete Konvente s'do te pengoje Shtetet anetare nga konkludimi i marreveshjeve te vecanta midis tyre ose nga vijueshmeria per te zbatuar marreveshjet tashme te perfunduara ne lidhje me rikthimin e pasurise kulturore te larguar, per cfaredo arsye, nga territori i origjines, perpara hyrjes ne fuqi te kesaj Konvente per shtetet e interesuara.

Neni 16

Shtetet Anetare te kesaj Konvente duhet ne raportet e tyre periodike te paraqitura Komerences se Pergjithshme te Organizares Kulturore Arsimore Shkencore te Kombeve te Bashkuara me te dhena dhe ne menyren qe vendoset prej saj, te japin informacion mbi kushtet legjislative dhe administrative te cilat i kane miratuar dhe mbi veprime te tjera qe ata kane ndermarre per aplikimin e kesaj Konvente, se bashku me detajet e pervojës se fituar ne kere fushe.

Neni 17

1. Shtetet anetare te kesaj Konvente mund te kerkojne asistence teknike nga Organizata Arsimore, Kulturore dhe Shkencore e Kombeve te Bashkuara, vecanerisht per sa i perket:

- (a) Informacionit dhe arsimit;
- (b) konsultimit dhe keshillimit me eksperte;
- (c) koordinimit dhe detyra te mira.

2. Organizata Arsimore, Kulturore dhe Shkencore e Kombeve te Bashkuara me nismen e saj mund te kryeje studime kerkimore dhe te botoje studimet mbi ceshtjet e lidhura me levizjet e paligjshme te pasurise kulturore.

3. Per kete qellim, Organizata Arsimore, Kulturore dhe Shkencore e Kombeve te Bashkuara mund gjithashtu te kerkoje kooperimin e ndonje organizate joqeveritare kompetente.

4. Organizata Arsimore, Kulturore dhe Shkencore e Kombeve te Bashkuara mund, me nismen e saj te beje propozime Shteteve anetare te kesaj Konvente per zbatimin e tyre.

5. Me kerkesen e te pakten dy Shteteve anetare te kesaj Konvente te cilat jane te angazhuara ne nje debat mbi zbatimin e tij, UNESCO mund te zgjeroje pushtetet e saj te mira, per te arritur nje zgjidhje midis tyre.

Neni 18

Kjo Konvente eshte e hartuar ne Anglisht, Frengjisht, Rusisht dhe Spanjisht, te kater tekstet kane te njejten fuqi autoritare.

Neni 19

1. Kjo Konvente do t'i nenshtrohet ratifikimit ose pranimit nga Shtetet anetare te Organizates Arsimore, Kulturore dhe Shkencore te Kombeve te Bashkuara ne perputhje me procedurat konstitucionale respektive te tyre.

2. Instrumentet e ratifikimit ose te pranimit do te depozitohen prane Drejtorit te Pergjithshem te Organizates Arsimore, Kulturore dhe Shkencore te Kombeve te Bashkuara.

Neni 20

1. Kjo Konvente do te jete e hapur per pranim per te gjitha shtetet jo anetare te Organizates Arsimore, Kulturore dhe Shkencore te Kombeve te Bashkuara te cilat jane te ftuara te pranohen ne te nga Bordi Ekzekutiv i Organizates.
2. Pranimi do te ndikohet nga depozitimi i nje dokumenti te pranimit prane Drejtorit te Pergjithshem te Organizates Arsimore, Kulturore dhe Shkencore te Kombeve te Bashkuara.

Neni 21

Kjo Konvente do te hyje ne fuqi tre muaj pas dates se depozitimit te dokumentit te trete te ratifikimit, pranimit ose hyrjes, par verem me respektimin e atyre shteteve te cilat i kane depozituar dokumentet e tyre respektive ne/ose perpara kesaj date. Ajo do te hyje ne fuqi ne lidhje me cdo shtet tjeter tre muaj pas depozitimit te dokumentit te ratifikimit, pranimit ose hyrjes.

Neni 22

Shtetet pale ne kete Konvente e pranojne se Konventa eshte e zbatueshme jo vetem ne territoret e tyre metropolitane par gjithashtu edhe tek te gjitha territoret per marredheniet nderkombetare te te cilave ata jane pergjegjes; ata marrin persiper te konsultohen, ne se eshte e domosdoshme, me qeverite ose autoritetet e tjera kompetente te ketyre territoreve ne ose para ratifikimit, pranimit ose hyrjes me qellim qe te sigurojne zbatimin e Konventes brenda ketyre territoreve dhe per te njoftuar Drejtorin e Pergjithshem te Organizates Arsimore, Kulturore dhe Shkencore te Kombeve te Bashkuara te ketyre territoreve per te cilat ajo zbatohet, njoftim qe do te gjeje zbatim tri muaj pas dates se marrjes se njoftimit.

Neni 23

1. Secili Shtet Pale ne kete Konvente mund te denoncoje Konventen ne emer te tij ose ne emer te ndonje territori ku eshte pergjegjes per marredheniet e tij nderkombetare.
2. Denoncimi do te njoftohet me ane te dokumentit te shkruar, te depozituar tek Drejtori i Pergjithshem i Organizates Arsimore, Kulturore dhe Shkencore te Kombeve te Bashkuara.
3. Denoncimi do te kryhet dymbedhete muaj pas marrjes se dokumentit te denoncimit.

Neni 24

Drejtori i Pergjithshem i Organizates Arsimore, Kulturore dhe Shkencore te Kombeve te Bashkuara do te informoje Shtetet anetare te Organizates, Shtetet jo anetare te

Organizates te cilat jane permendur ne nenin 20, si dhe Kombet e Bashkuara per depozitimin e te gjitha dokumenteve te ratifikimit, pranimet dhe hyrjes sipas neneve 19 dhe 20, dhe te njoftimeve dhe denoncimeve respektivisht sipas neneve 22 dhe 23.

Neni 25

1. Kjo Konvente mund te rishikohet nga Konferenca e Pergjithshme e Organizates Arsimore, Kulturore dhe Shkencore te Kombeve te Bashkuara. Cdo rishikim i tille sidoqofte do te detyroje vetem Shtetet te cilat do te behen Pale ne Konventen e rishikuar.
2. Nese Konferenca e Pergjithshme do te miratoje nje konvente te re duke rishikuar kete Konvente ne teresi ose ne pjese, pastaj, ne se konventa e re e parashikon ndryshe, kjo Konvente do te pushoje se qenuri e hapur per ratifikim, pranim ose hyrje, qe nga data ne te cilen konventa e re e rishikuar hyn ne fuqi.

Neni 26

Ne perputhje me Nenin 102 te Kartes se Kombeve te Bashkuara, kjo Konveme do te regjistrohet tek Sekretariati i Kombeve te Bashkuara me kerkese te Drejtorit te Pergjithshem te Organizates Arsimore, Kulturore dhe Shkencore te Kombeve te Bashkuara.

E realizuar ne Paris me shtatembedhjete neuter 1970, ne dy kopje autentike qe mbajne nenshkrimin e Presidentit te sesionit te gjashtembedhjete te Konferences se Pergjithshme dhe

te Drejtorit te Pergjithshem te Organizates Arsimore, Kulturore dhe Shkencore te Kombeve te

Bashkuara, dhe e vertetuar ne kopje origjinale te cilat do te shperndahen tek te gjitha shtetet qe jane permendur ne nenet 19 dhe 20 si dhe tek Kombet e Bashkuara.

E mesipermja eshte teksti autentik i Konventes se miratuar ne kohen e duhur nga Konferenca e Pergjithshme e Organizates Arsimore, Kulturore dhe Shkencore te Kombeve te

Bashkuara gjate sesionit te saj te gjashtembedhjete, e cila u mbajt ne Paris dhe u shpall e mbyllur me 14 Nentor 1970.

Ne mirebesim ne kemi vene nenshkrimet tona me 17 Nentor 1970.

**PRESIDENTI I KONFERENCES
SE PERGJITHSHME**

DREJTORI I PERGJITHSHEM

Shtet i Ratifikuar (R), Pranimet (A)

Hyrjet (a)

Si ne 31 tetor 1984

Depozituesi:

Hyrja ne fuqi:

Tekstet zyrtare:

Unesco

24 prill 1972, ne perputhje me nenin 21

Anglisht, Frengjisht, Rusisht, Spanjisht

Regjistrimi prane Sekretariatit te Kombeve te Bashkuara: 9 maj 1972

Nr.11806

Data e depositimit

Algjeria	24 Qershor	1974 R	
Argjentina	11 Janar	1973 R	
Bolivia	4 Tetor	1976 R	
Brazili	16 Shkurt	1973 R	
Bullgaria	15 Shtator	1971 R	
Kameruni	24 Maj	1972 R	
Kanada	28 Mars	1978 A	
Rep. Qendrore e Afrikes	1 Shkurt	1972 R	
Kuba	30 Janar	1980 R	
Qipro	19 Tetor	1979 R	
Cekoslavakia	14 Shkurt	1977 A	
Kamboxhia demokratike	26 Shtator	1972 R	
Rep. Dem. Pop e Korese	13 Maj	1983 R	
Republika Domenikane	7 Mars	1973 R	
Ekvador	24 Mars	1971 A	
Egjipt	5 Prill	1973 A	
Salvador	20 Shkurt	1978 R	
Rep. Dem. e Gjermanise	16 Janar	1974 A	
Greqi	5 Qershor	1981 R	
Guine	18 Mars	1979 R	
Honduras	19 Mars	1979 R	
Hungari	23 Tetor	1978 R	
Indi	24 Janar	1977 R	
Iran	27 Janar	1975 A	
Irak	12 Shkurt	1973 A	
Itali	2 Tetor	1978 R	
Jordani	15 Mars	1974 R	
Kuvait	22 Qershor	1972 A	
Libani Arab	9 Janar	1973 R	
Mauritania	27 Prill	1978 A	
Mauri	27 Shkurt	1978 A	
Meksike	4 Tetor	1972 A	
Nepal	23 Qershor	1976 R	
Nikaragua	19 Prill	1977 R	
Niger	16 Tetor	1972 R	
Nigeria	24 Janar	1972 R	

Gmani	2	Qershor	1978	A
Pakistani		30 Prill	1981	R
Panama		13 Gusht	1973	A
Peru	24	Tetor	1979	A
PoIoni	31	Janar	1974	R
Katar	20	Prill	1977	A
Rep. e Korese	14	Shkurt	1983	A
Arabia Saudite	8	Shtator	1976	A
Sri Lanka	7	Prill	1977	A
Rep. Arabe e Sirise	21	Shkurt	1975	A
Tuillzia		10 Mars	1975	R
Turqi	21	Prill	1981	R
Rep. e Bashk e Tanzanise		2 Gusht	1977	R
SH.B.Amerikes	2	Shtator	1983	A
Urugai	9	Gusht	1977	R
Jugoslavia	3	T etor	1972	R
Zaire	23	Shtator	1974	R

Deklarime dhe rezerva

Kuba

(Perkthim) "Qeveria e Republikës së Kubës konstaton se zbatimi i klauzolave të Neneve 22 dhe 23 të Konventës është në kundërshtim me Deklaratën e Dhenies së Pavaresisë Popujve dhe Vendeve Koloniale (Rezoluta 1514) e aprovuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 14 Dhjetor 1960, e cila shpall domosdoshmerinë e dhenies fund kolonializimit sa më shpejt e pa kushte në të gjitha format dhe shfaqjet e tij." (Shiko Letren LA/Depozituar/ 1980/7 11 Mars 1980).

Çekosllovakia

"Duke pranuar Konventën, Qeveria e Republikës Socialiste të Çekosllovakisë dëshiron të deklarojë se ruajtja e gjendjes së varesisë të vendeve të caktuara nga të cilat klauzolat e neneve 12, 22 dhe 23 burojnë është në kundërshtim me përmbajtjen dhe objektivat e Deklaratës së Asamblese së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara (Rezoluta J.514) mbi Dhenien e Pavaresisë Popujve dhe Vendeve Koloniale të 14 Dhjetorit 1960.

Qeveria e Republikës Socialiste të Çekosllovakisë me tej daklaron në lidhje me Nenin 20 të Konventës, sipas problemeve të cilat ajo rregullon, duhet të jete e hapur gjithashtu edhe për Shtetet jo-anetare të Organizatës Arsimore, Kulturore dhe Shkencore të Kombeve të Bashkuara pa patur nevojë të ftohen nga Këshilli Ekzekutiv i Organizatës Arsimore, Kulturore dhe Shkencore të Kombeve të Bashkuara". "(shiko Letren LA/Depozituar 6 të 8 prillit 1977)

Hungaria

"Nenet 12, 22 dhe 23 të Konventës janë në kontradike me Rezolutën e Asamblese së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara 1514 (XV) të 14 Dhjetorit 1960, e cila shpallte domosdoshmerinë e dhenies fund të kolonializimit sa më shpejt e pa kushte në të gjitha format dhe shfaqjet e tij. Neni 20 i Konventës nuk është në përputhje me parimin e

barazise se sovranitetit te Shteteve; ne lidhje me çeshtjet te cilat ajo rregullon, Konventa duhet te jete e hapur per te gjitha shtetet pa asnje kufizim" (Shiko letren LA/Depozituar/1978/17 te 12 Dhjetorit 1978).